



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 17, paragrafi 1, pika 7 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë 12/19), Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit shpall

THIRRJE

PËR APLIKIM PËR VËZHgues TË PJESËMARRËSVE NË FUSHATËN ZGJEDHORE ZGJEDHJE LOKALE 2021

Për monitorim efektiv në fushatën zgjedhore të pjesëmarrësve në zgjedhjet e ardhshme lokale, KSHPK duhet të punësojë 50 vëzhgues për komunat sipas renditjes më poshtë:

nr. rendor	Komuna / t	Numri i vëzhguesve
1	Aerodrom dhe për Qytetin e Shkupit	1
2	Butel dhe për Qytetin e Shkupit	1
3	Gazi Babë dhe për Qytetin e Shkupit	1
4	Gjorçe Petrov dhe për Qytetin e Shkupit	1
5	Karposh dhe për Qytetin e Shkupit	1
6	Kisela Voda dhe për Qytetin e Shkupit	1
7	Saraj dhe për Qytetin e Shkupit	1
8	Qendër dhe për Qytetin e Shkupit	1
9	Çair dhe për Qytetin e Shkupit	1
10	Shuto Orizar dhe për Qytetin e Shkupit	1
11	Haraçinë	1
12	Ilinden	1
13	Çučer Sandevë	1
14	Kumanovë	1
15	Likovë	1
16	Kratovë	1
17	Kriva Pallankë	1
18	Shtip	1
19	Koçan	1
20	Makedonska Kamenica	1
21	Dellçevë	1
22	Prilep	1
23	Manastir	1
24	Kërçovë	1

25	Resnjë	1
26	Ohër	1
27	Mavrovë dhe Rostushë	1
28	Petrovec dhe Zelenikovë	1
29	Studenican dhe Sopsishte	1
30	Nagoricani i Vjetër dhe Rankovc	1
31	Veles dhe Çashkë	1
32	Sveti Nikole dhe Lozovë	1
33	Vinica dhe Zletovë	1
34	Berovë dhe Pehçevë	1
35	Novo Sellë dhe Bosilovë	1
36	Strumicë dhe Vasilevë	1
37	Radovish dhe Konçe	1
38	Gjevgjeli dhe Bogdanci	1
39	Vallandovë dhe Dojran	1
40	Negotinë dhe Demir Kapi	1
41	Dollnen dhe Krivogashtani	1
42	Mogilla dhe Novaci	1
43	Krushevë dhe Demir Hisar	1
44	Makedonski Brod dhe Pllasnicë	1
45	Dibër dhe Qendër Zhupa	1
46	Probishtip, Çeshinovë dhe Obleshevë, Karbinci	1
47	Kavadar, Gradsko dhe Rosoman	1
48	Strugë, Vevçan dhe Debrçë	1
49	Gostivar, Vrapçisht, Brvenicë dhe Bogovinë	1
50	Tetovë, Zhelinë, Jegunovc dhe Tearcë	1

KUSHTET PËR PJESËMARRJE:

Kandidatët e interesuar duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

- Të mos jetë anëtar i ndonjë partie politike;
- Gjatë fushatës zgjedhore mos ketë angazhim pune;
- Të ketë në dispozicion automjet motorik;
- Të ketë patentë shoferi të kategorisë B;
- Të ketë njohuri themelore në lidhje me format e promovimit të partive politike dhe kryerjen e fushatave zgjedhore;
- Të jetë banor/e i/e një qyteti / vendbanimi në komunën për të cilin ai / ajo aplikon;
- Të ketë telefon celular për fotografi dhe lidhje interneti;

MËNYRA E APLIKIMIT:

Kandidatët e interesuar duhet të plotësojnë formularin "Aplikim për analist" dhe "Deklaratën" të cilat janë pjesë integrale e Aplikimit të cilat janë në dispozicion në ueb faqen e Komisionit Shtetëror për

Parandalimin e Korrupsionit www.dksk.mk dhe së bashku me dokumentet e nevojshme të dorëzohen në mail adresën: izbori@dksk.org.mk

AFATI I APLIKIMIT:

Afati i aplikimit do të zgjasë deri të martën, 31.08.2021.

MËNYRA E ZGJEDHJES:

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet nga persona të autorizuar në KSHPK dhe IFES, pas intervistës dhe testimit të kryer paraprakisht. Koha për kryerjen e intervistës do të përcaktohet në mënyrë shtesë me secilin nga kandidatët që do të plotësojë kushtet e mësipërme.

OBLIGIMET E VËZHguesVE:

- **Të marrin pjesë** në trajnim një ditor për njoftim me metodologjinë e punës dhe mënyrën e raportimit;
- **Të marrin pjesë** në punëtori për vëzhgimin e financimit politik dhe zgjedhjeve

Në territorin e komunës për të cilën janë zgjedhur të **kryejnë:**

- **vëzhgim, shënim dhe dokumentim** të aktiviteteve të pjesëmarrësve në fushatën zgjedhore: shpërndarja e materialit reklamues, mbajtja e ngjarjeve, reklamim dhe aktivitete të tjera.
- Monitorimi ditor i faqeve zyrtare të partive ose pjesëmarrësve në zgjedhjet lokale në mënyrë që të merren informacione për aktivitetet e tyre në një qytet specifik, vendbanim;
- Monitorim ditor i rrjeteve sociale dhe portaleve që kryejnë reklamim politik;
- Monitorim, regjistrim dhe dërgim i informacionit në KSHPK për të gjitha bilbordet e vendosura, siti lajt, posterat, panotë dhe format e tjera të reklamimit;
- Vëzhgim, regjistrim dhe dërgim i informacioneve në KSHPK për mitingje të realizuara, tubime ose forma të tjera të mbledhjes masive të qytetarëve: vëmendje e veçantë për transportin e qytetarëve nga komunat e tjera, vendosja e skenave, sistemi i zërimit, muzika, angazhimi i këngëtarëve/artistëve, etj.;
- Monitorim, regjistrim dhe dërgim i informacionit në KSHPK për vendndodhjen e selive aktive lokale të partive;
- **Të dorëzojnë raporte** në KSHPK.

DETYRIMET E KSHPK:

KSHPK-ja, ka detyrimet e mëposhtme ndaj vëzhguesve të zgjedhur:

- Të lidhë kontratë për rregullimin e plotësimit të obligimeve të ndërsjella;
- Të zhvillojë trajnim një ditor për vëzhguesit për të specifikuar aktivitetet - subjekti i vëzhgimit, mënyra e dokumentimit dhe raportimi;
- Të paguaj kompensim të njehershmëm deri në 9.500 denarë për angazhim;
- Vëzhguesit që mbulojnë 2-3 komuna (rurale) do të kenë kompensim të shpenzimeve për karburant sipas konsumit mesatar dhe çmimit të karburantit për automjetin e përdorur për ditët e vëzhgimit dhe kilometrat e kaluara dhe
- Për kompensimet e paguara, të paguajë shumën e tatimit mbi të ardhurat personale.

PERIUDHA E ANGAZHIMIT:

Periudha e angazhimit ёshtё nga dita e fillimit tё fushatёs zgjedhore deri nё ditёn e zgjedhjeve.

**KOMISIONI SHТETЁROР ПЁR
PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT**
Kryetare,
Biljana Ivanovska

